

---

## STATUTI i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “Intrust” SH.P.K.

Parashikimet e ketij Statuti zbatohen per nje Shoperi me Pergjegjesi te Kufizuar (SHPK).

Ne kete statut:

- “Ligi” eshte Ligji Nr. 9901, dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar;
- “Statuti” eshte Statuti i shoqerise;
- QKB” – Qendra Kombetare e Biznesit ne Shqiperi.

### KREU I Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

#### **Neni 1**

##### **Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, me 19.11.2022, ne te nenshkruarit: Edison Troshani i datelindjes 29.06.1978 i pajisur me karten e identitetit H80629095F, dhe Gerta Avrami e datelindjes 24.01.1977 e pajisur me karten e identitetit H75124110W regjistrojme nje shoperi me pergjegjesi te kufizuar me emrin “Intrust” Sh.p.k., bazuar ne akt themelin e dates 19.11.2022.

#### **Neni 2**

##### **Objekti**

2.1 Kryerja e Sherbimeve te auditimit dhe e sherbimeve te tjera te dhenies se sigurise, te sherbimeve te lidhura, sipas percaktimit te ketyre sherbimeve te dhena nga IFAC (Federata Nderkombetare e kontabilisteve). Kryerja e Sherbime te kontabilitetit. Sherbimet e mbajtjes se kontabilitetit, deklarimeve tatimore dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ngritura, permiresimi dhe mirembajtja e sistemeve kontabel dhe te kontrollit te brendeshem te njesive ekonomike si dhe trajnimin professional te personelit qe eshte ngarkuar me funksionimin e ketyre sistemeve. Pergatitja e raporteve periodike financiare sipas nevojave te drejtuesve te biznesit. Konsulencia ekonomike, financiare dhe fiskale. Pergatitjen e planeve te biznesit per nevojat e drejtuesve dhe per palet e treta, rivleresim aktivitetesh, keshillime biznesi mbi mundesite e zhvillimit, keshillime per fillim aktiviteti tregtar etj. Konsulencia fiskale, per njohjen dhe zbatimin e ligjislacionit fiskal. Sherbime te tjera te lidhura me shoqerite tregtare, si: ndarje, bashkim, perthithje, administrim,

likujdim, falimentim; rritje dhe zvogelim kapitali; hetime te posacme, perfaqesim ne ceshje gjyqesore qe kerkojne nje ekspertize kontabile ose fiskale, tregtare, ekonomike etj. Perfaqesimi i njesive ekonomike si per qellime tatimore, gjyqesore apo kundrejt paleve te treta. Ofrimi i sherbimeve te mbajtjes se selise per njesi te tjera ekonomike, etj. Realizimin e kontratave, marreveshjeve, ortakerive shoqerive te perbashketa apo formave te tjera te lejuara nga legjilacioni shqiptar, me persona fizike dhe juridike, shqiptar ose te huaj, per te realizuar operacione tregetare dhe veprimtari te ndryshme qe jane te nevojshme dhe me interes per shoqerine si dhe per cdo lloj aktiviteti qe do ti sherbeje realizimit te objektit.

Gjithashtu shoqeria mund te ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjeter te pashprehur me siper, qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni3

Kohezgjatja

3.1. Kohezgjatja e shoqerise do te jete e pacaktuar.

Neni 4

Selia

4.1. Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: Njesia Bashkiake nr. 5, Rruga Dervish Bej Mitrovica, Pallati Kristi Co Nr. 6, Kati perdhe, Njesia nr 1.

## **KREU II Kapitali**

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

5.1 Kapitali fillestar i kompanise do te 5 000 000 leke leke te ndare ne 2 kuote me vlerë nominale 2 500 000 leke per kuote ku:

Edison Troshani zoteron 1 kuote korresponduese e 80% te kapitalit me vlerë 4 000 000 leke.

Gerta Avrami zoteron 1 kuote korresponduese e 20% te kapitalit me vlerë 1 000 000 leke.

5.2. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

## Neni 6

### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

- 6.1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.
- 6.2. Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- 6.3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.
- 6.4. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

- 7.1. Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashegimise;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.
- 7.2. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 7.3. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

## KREU III Organet Vendimmarrese dhe Drejtuese

## Neni 8

### Organji Vendimmarres

- 8.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 8.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 8.3. Asambleja e perjithshme e ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:
- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
  - ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;

- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

8.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

8.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

8.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## Neni 9

### **Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

9.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

9.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

## Neni 10

### **Kuorumi**

10.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

10.2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

10.3. Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungesës se kuorumi te permendor me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

11.1. Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

11.2. Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve
- d) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

11.3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## Neni 12

### Perjashtimi nga e drejta e votes

12.1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:


- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

12.2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohe te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

## Neni 13

### Administrimi

13.1. Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.



13.2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

13.3. Znj. Gerta Avrami eshte Administrator i shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

## Neni 14

### Kompetencat e Administratoreve

14.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se
- veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- d) krijojnë nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- e) raportojne perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

14.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

14.3. Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

14.4. Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 15

### Pergjegjesite e Administratorit

15.1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

15.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

15.3. Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

15.3.1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesid;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojsphem.

15.3.2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjen ndaj shoqerise per çdo tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

15.3.3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij nenit, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

15.4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

a) ukthenortakevekontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

15.5. Perveç padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plotë te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **KREU IV** **Viti finanziar-ekspertet**

##### **Neni 16**

###### **Viti Financiar**

16.1. Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17**

###### **Ekspertet**

17.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

17.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perqatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'I shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

#### **KREU V** **Prishja –riorganizimi i shoqerise**

##### **Neni 18**

###### **Prishja dhe likuidimi**

18.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- me hapjen e procedurave te falimentimit;

ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";

d) me vendim te gjykates;

18.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

18.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

18.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

18.5. Nese Ortaket nuk merrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

## Neni 19

### Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja

19.1. Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare."

## Neni 20

### Baza Ligjore

20.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

20.2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

## ORTAKET E SHOQERISE

Edison Troshani

*Edison Troshani*

Gerta Avrami

*Gerta Avrami*

1. *Endothelial*  
2. *Smooth muscle*

3. *Neuronal*

4. *Smooth muscle*

5. *Smooth muscle*

6. *Smooth muscle*

7. *Smooth muscle*

8. *Smooth muscle*

9. *Smooth muscle*

10. *Smooth muscle*

11. *Smooth muscle*

12. *Smooth muscle*

13. *Smooth muscle*

14. *Smooth muscle*

15. *Smooth muscle*

16. *Smooth muscle*

17. *Smooth muscle*

18. *Smooth muscle*

19. *Smooth muscle*

20. *Smooth muscle*

21. *Smooth muscle*

22. *Smooth muscle*

23. *Smooth muscle*

24. *Smooth muscle*

25. *Smooth muscle*

26. *Smooth muscle*

27. *Smooth muscle*

28. *Smooth muscle*

29. *Smooth muscle*

30. *Smooth muscle*

31. *Smooth muscle*

32. *Smooth muscle*

33. *Smooth muscle*

34. *Smooth muscle*

35. *Smooth muscle*

36. *Smooth muscle*

37. *Smooth muscle*

38. *Smooth muscle*

39. *Smooth muscle*

40. *Smooth muscle*

41. *Smooth muscle*

42. *Smooth muscle*

43. *Smooth muscle*

44. *Smooth muscle*

45. *Smooth muscle*

46. *Smooth muscle*

47. *Smooth muscle*

48. *Smooth muscle*

49. *Smooth muscle*

50. *Smooth muscle*